



**Raporti i shqyrtimit të vërejtjeve dhe komenteve për Planin Rregullues të Hollësishëm për zonën Mati I-Vazhdimi i rrugës “B” (Bahri Fazliu)-pjesa jugore, sipas UA MMPH-Nr.05/2014 për përgjegjësitë e autoriteteve të Planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikim hapësinor si dhe sipas UA MAPL-NR.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në komuna,**

Nr.	Emri, mbiemri i parashtruesit	Vërejtje, propozim, sugjerim, kërkesë	Arsyetimi i grupit punues
1.	Driton Ajeti	Driton Ajeti, për parcelat me nr.2710-6 deri 2710-2 ZK Prishtinë, të shënuara në librin e ankesave nuk pajtohet me koeficientin e ndërtimit 2.8 dhe cekë se Kryetari i Komunës Shpend Ahmeti ka folur ne TV Klan Kosova për koeficient 4.0.	Ankesa e qytetarit Driton Ajeti nuk miratohet nga komisioni, për arsye se, planifikimi për këtë zonë është bërë duke respektuar kriteret e parapara me UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, si p.sh. vija ndërtimore, distanca mes ndërtesave, distanca nga parcelat fqinje, diellosja, gjelbërimi, etj.andaj koeficienti i ndërtimit 2.8, është maksimumi që është arritur për këtë zonë.
2.	Halim Hyseni	Halim Hyseni me ankesën e protokolluar me nr.04-070/01-204821/19 dt.21.08. 2019, ka shprehur mospajtim dhe kundërshtim të planit rregullues për lagjen e spitalit, Mati I, vazhdimi i rrugës “B”. Sipas ankuesit, ai posedon “shtëpi të legalizuar prej 255m <sup>2</sup> me ngrohje qendrore, garazhe, etj. me investim 300 000 euro dhe nuk pajtohet me koeficientin prej 2.8 dhe e cekë se nuk do të lejoj që të shfrytëzohet dhe viktimizohet për interesat e askujt”. Kërkesa e tij është që prona e tij të shpronësohet në mënyrë të drejtë, objektive dhe ligjore.	Lidhur me ankesën e qytetarit Halim Hyseni, komisioni ka vendosur si në vijim: -lidhur me koeficientin e ndërtimit të përcaktuar me këtë plan 2.8, nuk miratohet nga komisioni, për arsye se, planifikimi për këtë zonë është bërë duke respektuar kriteret e parapara me UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, si p.sh. vija ndërtimore, distanca mes ndërtesave, distanca nga parcelat fqinje, diellosja, gjelbërimi, etj.andaj koeficienti i ndërtimit 2.8, është maksimumi që është arritur për këtë zonë. - sa i përket kërkesës që prona e tij “të shpronësohet në mënyrë të drejtë, objektive dhe ligjore”, komisioni ju njofton se, sa i përket shpronësimeve, ky Plan jep dy mënyra të mundësisë së shpronësimeve: a) sipas koeficientit të ndërtimit, duke ndërtuar në etazhitet dhe b) sipas Ligjit për Shpronësim, ku vlerësimin e pronës e bën Ministria e Financave kurse pagesën –kompensimin e merrë përsipër Komuna.


3.	Sheqir Hyseni, Halim Hyseni, Selim Hyseni, Rrehman Duli, Shefki Ajeti, Mehmet Ajeti, Xheladin Ajeti dhe Emrush Ajeti	<p>Qytetarët Sheqir Hyseni, Halim Hyseni, Selim Hyseni, Rrahman Duli, Shefki Ajeti, Mehmet Ajeti, Xheladin Ajeti dhe Emrush Ajeti kanë protokoluuar ankesën me nr.04-070/01-208179/19 dt.26.08.2019 në emër të Sheqir Hysenit, me të cilën shprehin mospajtimin me planifikimin e propozuar me PRRH, vazhdimi I rrugës “ B” , Bahri Fazliu, pjesa jugore.</p> <p>Ankesa kryesisht ka të bëjë me koeficientin e propozuar për ndërtim 2.8. Në arsyeshmërinë e kësaj ankese thuhet se në këto parcela ekzistojnë shtëpi të ndërtuara që nga vitet e 70-ta. Disa nga këto shtëpi edhe pas djegies së tërësishme gjatë luftës janë rindërtuar pas luftës dhe janë bërë investime në këto ndërtesa.</p> <p>Këta pronarë-ankues, kanë dhënë propozim për rishikimin e këtij plani dhe rritjen e koeficientit të ndërtimit në 4.2, ku sipas tyre nuk ka nevojë të rritet lartësia e ndërtesave por vetëm gjerësia e tyre. Sipas tyre, me këtë plan nuk është trajtuar komplet prona e komunës si dhe zona ku gjendet aktualisht EULEX.</p> <p>Poashtu kërkesë e tyre është edhe që kjo pjesë e rrugës “B” të marr emrin e familjarit të tyre, albanologut Idriz Ajeti.</p>	<p>Ankesa e qytetarëve Sheqir Hyseni, Halim Hyseni, Selim Hyseni, Rrahman Duli, Shefki Ajeti, Mehmet Ajeti, Xheladin Ajeti dhe Emrush Ajeti nuk miratohet nga komisioni, për arsye se, planifikimi për këtë zonë është bërë duke respektuar kriteret e parapara me UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, si p.sh. vija ndërtimore, distanca mes ndërtesave, distanca nga parcelat fqinje, diellosja, gjelbërimi, etj.andaj koeficienti i ndërtimit 2.8, është maksimumi që është arritur për këtë zonë.</p> <p>Sa i përket emërtimit të rrugëve, ju njoftojmë se ky komision nuk ka kompetenca për emërtim të rrugëve, pasi që për këtë kompetent është Kuvendi Komunal.</p>
4.	Pa emër	<p>Pala ka vërejtje në incizimin e gjendjes faktike të shtëpisë, konkretisht në etazhitetin e shtëpisë ku jeton, ish baraka e Kombinatit ndërtimor “ Ramiz Sadiku”, ku sipas incizimit figuron etazhiteti P+0 dhe përshkruhet si ndërtesa e vjetër, ndërsa sipas tij ndërtesai është e re me etazhitet P+2. Ankuesi ka bashkëngjitur në libër vendimin e K.N. "Ramiz Sadiku" për ndërtimin e barakës dhe skicat ku ndodhet ndërtesa, me foto.</p>	<p>Pas verifikimit të gjendjes ekzistuese dhe fotove te prezentuara, komisioni miraton këtë ankesë dhe përmirësohet prezantimi i shtëpisë në fletën e gjendjes ekzistuese-faktike. Në pjesën grafike të këtij Plani, ku është prezantuar gabimisht etazhiteti i objektit ekzistues P+0 do të përmirësohet në P+2.</p>

5.	Qerim Gashi	<p>Me ankesën e protokolluar me nr.04-070/01-212197/19 dt.29.08.2019, pala ka shprehur mospajtim dhe kundërshtim për Planin Rregullues, vazhdimi i rrugës B. Ankuesit e kësaj kërkesë, i kanë bashkangjitur edhe dy ankesa-peticione të dorëzuara në Drejtorinë e Urbanizimit, Ndërtimit dhe Mbrojtjes së Ambientit në vitin 2010 dhe 2013.</p> <p>Ankuesit kanë shprehur pakënaqësinë e tyre lidhur me:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-koeficientin e ndërtimit, sipas tyre 2.7 dhe kërkojnë koeficient mbi 4;</li> <li>-gjendjen ekzistuese, ku procka ekzistuese vërshon në oborret e tyre dhe kundërmon në çdo kohë të vitit;</li> <li>- etazhitetin e ndërtesave të planifikuara jo të barabarta dhe</li> <li>- planifikimin e rrugës, sipas tyre parcelat 2712-12, 2712-11 dhe 2712-10 ZK Prishtinë nuk janë përfshirë në trasenë e rrugës.</li> </ul>	<p>Ankuesi Qerim Gashi dhe djemtë e tij, kanë shprehur pakënaqësinë e tyre lidhur me koeficientin e ndërtimit të përcaktuar me këtë plan 2.7 (sipas tyre) dhe kërkojnë koeficient të ndërtimit 4.2. Kjo ankesë-kërkesë nuk miratohet nga komisioni, për arsye se, planifikimi për këtë zonë është bërë duke respektuar kriteret e parapara me UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, si p.sh. vija ndërtimore, distanca mes ndërtesave, distanca nga parcelat fqinje, diellosja, gjelbërimi, etj.andaj koeficienti i ndërtimit 2.8, është maksimumi që është arritur për këtë zonë.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-Sa i përket vërshimeve dhe kundërmimit të erërave nga procka, kjo mund të zgjidhet vetëm me realizimin e këtij Plani;</li> <li>-Etazhiteti jo i barabartë në këtë Plan, është rrjedhojë e respektimit të UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, gjegjësisht distancave nga parcelat fqinje dhe distanca mes ndërtesave;</li> <li>-Parcelat kadastrale 2712-12, 2712-11 dhe 2712-10 ZK Prishtinë, të cilat janë të përfshira në trasenë e rrugës “B”, janë trajtuar në tërësi me koeficient ndërtimi 2.8, sikurse edhe parcelat tjera në kuadër të këtij Plani.</li> </ul>
----	-------------	---	---

6.	Shpend Kamberi	<p>Shpend Kamberi me dt.03.09.2019 në librin e ankesave, ankohet në prezantimin e gjendjes ekzistuese, se pse ndërtesa në parcelat 2712-2 dhe 2712-13 ZK Prishtinë, nuk është prezantuar si ndërtese me permbajtje fetare ne katet e para, njëherit kërkon që me këtë plan,</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- në ndërtesën e propozuar të planifikohet hapësira për falje-xhami, në katet -2, -1 (suteran), përdhesë dhe kati 1.</li> <li>- që në ndërtesën e planifikuar të parashihet dilatimi në kufizim të parcelës së skajshme në mënyrë që ndërtesa të ndërtohet në etapa (nëse nuk dakordohet bashkimi i kërkuar i parcelave),</li> <li>-gjithashtu ankuesi kërkon rritjen e koeficientit të ndërtimit dhe rritjen e etazheve,</li> </ul> <p>Ankuesi i njëjtë pra, Shpend Kamberi, me dt.04.09.2019, në librin e ankesave ka dhënë edhe një propozim që ndërtesa e planifikuar në parcelat e lartcekura, të dislokohej ashtu që të bashkëngjitet me ndërtesat shumëbanesore ekzistuese, pasi që, siç ceket në ankesë, në fasadën e ndërtesës ekzistues nuk ka hapje, pra kërkon që të ketë mundësi të zgjedhjes së pozicionimit të ndërtesës së planifikuar brenda parcelave të lartcekura.</p>	<p>Pas shqyrtimit të kërkesës së qytetarit Shpend Kamberi, komisioni ka vendosur që:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-sa i përket kërkesës për planifikimin e hapësirave për falje-xhamisë, në kuadër të ndërtesës shumbanesore dhe afariste në parcelat e kërkuarit, konkretisht në katet -2,-1(suteran), përdhese dhe kati 1, të ndërtesës së planifikuar, bazuar në ligjet në fuqi dhe normat e planifikimit nuk parashihet ndërtimi i hapësirave fetare – xhami, në kuadër të ndërtesave shumbanesore;</li> <li>-sa i përket kërkesës për dilatim në ndërtesën e planifikuar në kufizim të parcelës së skajshme në mënyrë që ndërtesa të ndërtohet në etapa, kjo kërkesë aprovet nga komisioni;</li> <li>- lidhur me kërkesën e qytetarit Shpend Kamberi, për rritjen e koeficientit të përcaktuar me këtë plan 2.8, kjo kërkesë nuk miratohet nga komisioni, për arsye se, planifikimi për këtë zonë është bërë duke respektuar kriteret e parapara me UA MMPH Nr.08/2017 për normat teknike të planifikimit hapësinor, si p.sh. vija ndërtimore, distanca mes ndërtesave, distanca nga parcelat fqinje, diellosja, gjelbërimi, etj., andaj koeficienti i ndërtimit 2.8, është maksimumi që është arritur për këtë zonë.</li> <li>- sa i përket propozimit që ndërtesa e planifikuar në parcelat 2712-2 dhe 2712-13 ZK Prishtinë, të dislokohej ashtu që të bashkëngjitet me ndërtesat shumëbanesore ekzistuese, komisioni nuk e aprovon këtë propozim për arsye se ndërtesat ekzistuese janë të ndërtuara pa leje ndërtimi dhe nuk janë trajtuar me këtë Plan.</li> </ul>
----	----------------	---	--

**Komisioni me dt.11.09.2019, sipas Vendimit 14-020/02-0094087/19 dt.24.04.2019 të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, në përbërje:**

Burbuqe Hydaverdi, kryesuese.....

Florim Krasniqi, anëtarë.....

Arta Sylejmani, anëtarë.....

Sazan Raskova, anëtarë.....

Fatbardha Mehmetukaj, anëtarë.....

Kushtrim Domaneku, anëtarë.....

Anita Osmani, anëtarë.....

Merita Rushiti, anëtarë.....

Avdurrahman Krasniqi, anëtarë.....

Makfiredt Abdullahu, anëtarë.....

Daut Humolli, anëtarë.....

PRISHTINË,

DT.11.09.2019



*Handwritten signatures in blue ink:*  
Fatbardha Mehmetukaj  
Kushtrim Domaneku  
Anita Osmani  
Merita Rushiti  
Avdurrahman Krasniqi  
Makfiredt Abdullahu  
Daut Humolli

